

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1317 Prot.

Tiranë, më 28.12 2016

VENDIM Nr. 155, datë 20.12.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 14 të datës 20.12.2016, pasi shqyrtoi projektin e ndryshuar "*Projektim dhe Mbikëqyrje e ndërhyrjes në sistemin e kanalizimeve të ujrave të ndotura të Durrësit*", -subjekti Drejtoria e Përgjithëshme e Ujësjetës Kanalizimeve" Durrës dhe propozimet në lidhje me të, paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "AD-STAR" sh.p.k. dhe individ i licencuar në arkeologji Z. Ylli Cerova,

VENDOSI:

1. Të miratojë projektin e ndryshuar "*Projektim dhe Mbikëqyrje e ndërhyrjes në sistemin e kanalizimeve të ujrave të ndotura të Durrësit*", -subjekti Drejtoria e Përgjithëshme e Ujësjetës Kanalizimeve" Durrës dhe propozimet në lidhje me të, paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "AD-STAR" sh.p.k. dhe individ i licencuar në arkeologji Z. Ylli Cerova.
2. Të realizohen sondazhet arkeologjike për Traktet Nr. 2, Nr. 4 dhe Nr. 12, të cilat pozicionohen në zonën arkeologjike "B" të tij, sipas konceptit të sondazheve të paraqitur në propozimet e shoqërisë së licencuar në arkeologji "AD-STAR" sh.p.k. dhe individit të licencuar në arkeologji Z. Ylli Cerova.
3. Investitori, për kryerjen e sondazheve arkeologjike të sipërpërmendur dhe për të gjithë zonën e përfshirë në traktet e tjera, për projektin "Projektim dhe Mbikëqyrje e ndërhyrjes në sistemin e kanalizimeve të ujrave të ndotura të Durrësit", duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me shoqërinë e licencuar në arkeologji, e cila duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për këto trakte, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë shoqëri.
4. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjeve të sipërpërmendura.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO TUKXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO